



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHETËTOR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

**Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:**

Komuna e Studeniçanit

**Lënda e revizionit:**

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë të llogarisë së buxhetit themelor (630) për vitin 2020

**Qëllimi i revizionit:**

Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore

**Gjendjet kyçe të konstatuara:**

- Në gjashtëmujorin e parë, realizimi i të hyrave të planifikuara në buxhet është 30%, ndërsa me rebalancë i njëjti është rritur për 20%, me çka është rritur mundësia e krijimit të detyrimeve;
- Raporti Vjetor nuk i përmban të gjitha plotësimet dhe nuk u miratua nga Këshilli;
  - Nuk llogaritet dhe arkëtohet kamata e kërkesave tatimore të cilët nuk janë paguar në kohë;
  - Nuk janë realizuar të hyra në bazë të kompensimeve për mirëmbajtjen e pastërtisë publike

**Mendimi i dhënë/përfundimi \*:**

Shprehim mendim të pavoritshëm për të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare, si dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikatat e vendosura

**Rekomandimet kyçe:**

- Planifikimi i buxhetit të bazohet në llogarit reale të burimet e veta duke pasur parasysh detyrimet e pashlyera;
- Përgatitjen e Raportit Vjetor të kompletuar, i cili do të miratohet nga Këshilli;
- Llogaritja dhe arkëtimi i kamatës për kërkesat të cilat nuk janë paguar në kohë;
- Kompensimi i arkëtuar për mirëmbajtjen e pastërtisë publike nga NPK Studeniçan, të paguhet çdo muaj në llogarinë e buxhetit.

**Dobësitë kyçe të sistemit:**

Dobësi në Ligjin për tatimet komunale të numrat tarifues 9 dhe 10 tatimet komunale për shfrytëzimin e rrugicave dhe rrugëve dhe mirëmbajtjen e ndriqimit publik.

Dobësi në Ligjin për tatimet e pronës për pajtueshmërinë me gjendjen e regjistrimit të patundshmërisë së komunës me regjistrin të cilën e udhëheq AKP e RMV-së.

**Vërejtjet e marra të draft-raportit:**

Nuk janë marrë vërejtje për draft-raportin e llogarisë së buxhetit themelor (630) për vitin 2020.

**Përgjigjet e vërejtjeve të marra:**

/

\* pozitive, me rezervë, të pavoritshëm, të përmbajtur